



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim paraprak përqendrimi

Rasti: Venice European Investments Capital S.p.A / Costa Edutainment S.p.A

Në datën 2 Nëntor 2015, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Marrëveshjes së Investimit” e nënshkruar midis Venice European Investments Capital S.p.A dhe aksionarëve kontrollues të shoqërisë Costa Edutainment S.p.A më datë 2 Tetor 2015, me objekt përfundimin e kontrollit të përbashkët të Costa Edutainment S.p.A nga Venice European Investments Capital S.p.A dhe Priora S.r.l. Ky transaksion është njoftuar për shkak të xhirove që realizon shoqëria Palladio Finanziaria S.p.a. e cila është një nga shoqëritë që kontrollon Venice European Investments Capital S.p.A, nëpërmjet degës së saj Hydro Energia s.r.l. në Shqipëri.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Venice European Investments Capital S.p.A:** është një shoqëri aktive në fushën e investimeve private dhe investimeve në infrastrukturë, etj.
- **Costa Edutainment S.p.A:** është aktive në menaxhimin e siteve dhe strukturave që i dedikohen kohës së lirë aktiviteteve kulturore dhe edukuese dhe kërkimit shkencor, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 2 , 10, pika 1.b) dhe 12 të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al